



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 854/prot.
13

Tiranë, më 05.12.2025

VENDIM
Nr. 64, datë 05.12.2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 132, DATË 08.11.2022

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 132, datë 08.11.2022, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Vorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 49, datë 5.4.2022, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në Bashkinë Vorë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Bashkia Vorë.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 132, datë 08.11.2022, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Vorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e këtij vendimi, në institucionin Bashkia Vorë, me urdhrin nr. 88, datë 13.10.2025, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 132, datë 08.11.2022, të Komisionerit”*, sipas objektit dhe drejtimeve që përmban programi i mbikëqyrjes, i cili është pjesë e këtij urdhri. Për nisjen e këtij procesi Bashkia Vorë është njoftuar me shkresën nr. 854 prot., datë 13.10.2025, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit”*.

Mbikëqyrja në subjekt u krye në datat 4-7 nëntor 2025. Në përfundim të procesit, grupi i punës mbajti një procesverbal, ku u evidentua situata në lidhje me ecurinë e masave të marra nga institucioni.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 132, datë 8.11.2022, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga Kryetari i Bashkisë dhe njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, vërej se situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Vorë, paraqitet si më poshtë vijon:

Në **pikën 2** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse që të zbatojë me përpikëri kërkesat e ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore gjatë procedurave të plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil. Ajo duhet të përfshijë në mënyrë të detajuar të gjitha pozicionet vakante në planin e rekrutimit për vitin 2023 dhe të përcaktojë afate të qarta konkurrimi. Përpara nisjes së konkurseve, njësia harton planin vjetor të pranimit dhe ia dërgon për miratim Kryetarit të Bashkisë, proces që duhet të mbyllet brenda muajit shkurt çdo vit. Për shkak të numrit të madh të pozicioneve të lira, njësia duhet të klasifikojë pozicionet ekzekutive sipas natyrës së tyre dhe, për pozicionet *“Specialist”* me kërkesa të njëjta, të zhvillojë konkurrenca të përbashkëta, sipas ligjit dhe vendimeve në fuqi.

Nga dokumentacioni i administruar konstatohet se, plani vjetor i rekrutimit është hartuar çdo vit nga njësia përgjegjëse brenda afatit ligjor. Në plan është përcaktuar qartë afati për realizimin e procedurave të konkurimit. Konkurrimet janë zhvilluar në mënyrë individuale për shkak se pozicionet e shpallura i përkasin grupit të pozicioneve të administrimit të posaçëm. Sa më sipër, vërtetohet nga aktet nr. 7540 prot., datë 30.12.2022, *“Plani vjetor 2023”*, akti nr. 550 prot., datë 26.1.2024, *“Plani vjetor 2024”* dhe akti nr. 568 prot., datë 30.1.2025, *“Plani vjetor 2025”*, të administruara nga grupi i punës.

Në **pikën 3** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Vorë të administrojë diplomën e shkollës së lartë dhe listën e notave për nëpunësin G. Delli, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Nga verifikimi i dokumentacionit vërej se njësia përgjegjëse e Bashkisë Vorë, në vijim të zbatimit të kësaj detyre ka administruar në dosjen personale të nëpunësit diplomën master

shkencor në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë 5 vjeçar (300 kredit) në degën “Planifikim dhe Menaxhim Urban”, Universiteti Polis.

Në **pikën 4** të dispozitivit të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Vorë, të vendosë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për punonjësin R. Muka, pasi nuk plotëson kriterin arsimor për njehsimin e diplomës universitare të përfutur jashtë vendit, sipas përcaktimit në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Në lidhje me zbatimin e kësaj detyre, konstatohet se, me Urdhrin nr. 5, datë 26.2.2024, “Për lirin nga shërbimi civil të z. Roland Muka”, ky punonjës është liruar nga shërbimi civil.

Në **pikën 5** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse të ndërpresë marrëdhënien e punës në shërbimin civil për dy nëpunësit A. Lala në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Biznesit” dhe A. Picari në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë dhe Sportit”, pasi ata nuk plotësojnë kriterin arsimor të detyrueshëm “Master shkencor” ose “Master profesional” me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar, vërehet se punonjësi A. Lala është liruar nga detyra me Urdhrin nr. 5, datë 5.2.2025, “Për lirim nga shërbimi civil të z. Astrit Lala”. Për punonjësin A. Picari është administruar akti nr. 311 prot., datë 3.11.2025, “Vërtetim” me anë të të cilit konfirmohet se ky punonjës është duke ndjekur studimet me kohë të plotë “Master shkencor” në degën Financë-Kontabilitet.

Në **pikën 6** të vendimit paralajmërues, njësisë përgjegjëse i është kërkuar të plotësojë mangësitë e konstatuara gjatë verifikimit të akteve të depozituara në dosjet personale të nëpunësve civilë.

Në zbatim të kësaj detyre, në momentin e mbikëqyrjes në subjekt me përzgjedhje u kontrolluan disa dosje individuale të nëpunësve, nga ku grupi i punës konstatoi se ato ishin të plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm të shoqëruar dhe me fletën prezantuese përkatëse konform akteve që rregullojnë administrimin dhe formën e dosjeve të personelit.

Në **pikën 7**, të vendimit paralajmërues të Komisionerit është kërkuar nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të drejtojë procesin e riformulimit të përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, në përputhje me rregullat e Vendimit nr. 142/2014 dhe orientimet e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes; të sigurojë që kopjet e nënshkruara të përshkrimeve të punës të vendosen në dosjet personale të çdo nëpunësi civil dhe të përdoren gjatë miratimit të strukturës së institucionit.

Nga verifikimi i kryer nga grupi i punës në subjekt për disa përshkrime pune të përzgjedhura në mënyrë rastësore, rezultoi se përshkrimet e punës ishin hartuar dhe ishin bërë pjesë e dosjes individuale të nëpunësve.

Për sa u parashtrua më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e institucionit, Bashkia Vorë, janë zbatuar detyrat e lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 132, datë 27.07.2024, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 132, datë 08.11.2022, të Komisionerit, *"Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Vorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë"*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Vorë duke zbatuar detyrat e lëna të dispozitivit të Vendimit nr. 132, datë 08.11.2022.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Vorë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

